

DEKRET
Nr. 440, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Oficer i Madh i Urdhrit Suprem të Shqiponjës”
zotit Aurel Plasari**

“Në vlerësim të një kontributi poliedrik mbi 50-vjeçar, unikal për nga prurjet në fushat kryesore të mendimit, si edhe të kërkimit shkencor në Shqipëri, dhe më gjerë, në Evropën Juglindore, duke krijuar një trashëgimi të vyer dhe duke çelur perspektiva shumë premtuese në fushën e letrave, publicistikës, përkthimit dhe, mbi të gjitha, në lëmin e albanologjisë”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj